

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-77/13

Prishtinë, 19 shkurt 2014

Në çështjen juridike të:

Xh.P.

Istog

Pala ankuese

kundër

M.R.R.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/19/2008 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA37025), të datës 20 prill 2008, pas shqyrtimit të mbajtur më 19 shkurt 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

Hedhet si e papranueshme ankesa e Xh. P. kundër vendimit Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/19/2008 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA37025), të datës 20 prill 2008.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 24 2007, M.R.R. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar që të njihet si pronar i një prone, ngastrës numër 246, arë e klasës së dytë, në zonën Podkućnice, Ljubozda, Istog. Ai ka deklaruar se ishte pronar dhe ka kërkuar ri-posedimin. Ai ka deklaruar se e kishte humbur posedimin e pronës më 18 qershor 1999 dhe se humbja ishte rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë. Për të mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur një fletë poseduese numër 27, të lëshuar nga Komuna e Istogut (Administrata për Gjeodezi).
2. Ekipi i AKP-së ka bërë njoftimin e pronës duke vendosur një shenje në arë. Njoftimi nuk ishte kryer në mënyrën e duhur dhe se shenja ishte mjaft e dukshme. Brenda afati prej 30 ditësh për përgjigje në kërkesë, askush nuk ka kërkuar që të nënshkruaj njoftimin për pjesëmarrje.
3. Me vendimin KPCC/D/A/19/2008 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA37025) të datës 20 prill 2008, Komisioni ka miratuar kërkesën. Organi vendimmarrës ka konsideruar se paraqitësi i kërkesës kishte dëshmuar të drejtën e tij pronësore dhe se posedimi i tokës ishte humbur për shkak të konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999.
4. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 16 shkurt 2011.
5. Më 22 shkurt 2013, Xh. P. ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Pala ankuese pretendon se ka prova të reja dhe ka paraqitur kontratën e shitblerjes me numër 488/2009, të datës 30 Mars 2009. Kontrata ka të bëjë për bartjen e tokës, që është objekt i kësaj lënde. Më 30 mars 2009, (që do të thotë pas marrjes së vendimit të KKPK-së), pala ankuese e kishte blerë pronën nga paraqitësi i kërkesës.
6. Paraqitësi i kërkesës nuk është përgjigjur në ankesë, sipas shënimit të bërë nga një zyrtar i KKPK-së i cili kishte biseduar në telefon me paraqitësin e kërkesës, ku ky i fundit kishte konfirmuar se ia kishte shitur pronën palës ankuese.

Arsyetim Ligjor:

7. Ankesa është e palejueshme (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) pasi që pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë.
8. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 thekson si në vijim: *"Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë [...]".* Gjithashtu, neni 176.1 i Ligjit 03/L-006 për Procedurën Kontestimore parasheh se e drejta për parashtrim të ankesës i përket palëve në procedurën në shkallë të parë.
9. Palë në kërkesë dhe në procedurën e përafërta është *"çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë [...], me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive në pajtim me nenin 10.1"* (neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).
10. Pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën e shkallës së parë pranë KKPK-së. Pala ankuese nuk e arsyeton këtë në asnjë mënyrë me qëllim që tani të pranohet si palë në procedurë.
11. Gjykata vëren se njoftimi është kryer siç duhet. Ekipi i AKP-së ka vendosur shenjen informuese në tri gjuhët – shqip, serbisht dhe anglisht në arë.
12. Nuk ka ndonjë arsye se përse pala ankuese nuk e kishte informuar AKP-në për qëllimin e tij për të marrë pjesë në procedurë, gjë që është dashur ta bënte. Pasi që ai nuk ka arsyetim se përse nuk kishte marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë pranë AKP-së, ky lëshim shkon në dëm të tij.
13. Prandaj, ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe me nenin. 195.1 nen paragrafi (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore).
14. Pasi që ankesa është e palejueshme, Gjykatës Supreme nuk i lejohet që të vendos as për çështjen e juridiksionit të KKPK/Kolegjit të Apelit apo për çështje ligjore lidhur me blerjen e ngastrës.

Obiter dictum:

15. Gjykata Supreme përkujton se vendimi i KKPK-ës vendos mbi të drejtën e pronësisë në pronën e kontestuar në kohën e dhënjes së vendimit. Transaksionet e mundshme që kanë mundur të ndodhin pas kësaj date nuk ndikohen nga vendimi.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it